



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.102/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit H. S., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 lidhur me nën paragrafi 1.4 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.74/22 të datës 01.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.852/2023, të datës 22.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit H. S., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm P.nr.74/22 të datës 01.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.852/2023, të datës 22.09.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan-Departamenti i Përgjithshëm me aktgjykimin P.nr.74/22 të datës 01.06.2023, të dënuarin H. S. e ka shpall fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 lidhur me nën paragrafi 1.4 të KPRK, për të cilën veprë e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € si dhe në emër të kompensimit për Viktimat e Krimit të paguaj shumën prej 30 €. E dëmtuara L. G. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.852/2023 e datës 22.09.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit H. S., avokati Gëzim Kollçaku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimet kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.59/2024 e datës 16.02.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi.1 lidhur me nenin 436 paragrafi.1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë, pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se pas deklaramit të dënuarit se a e pranon fajësinë, gjykata ka marr aktvendim për pranimin e fajësisë së të dënuarit duke mos u bindur në mënyrë të plotë se i dënuari a e ka kuptuar natyrën e veprës penale dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Theksohet se kur e themi këtë e kemi parasysh faktin se sipas familjarëve dhe avokatit mbrojtës atëkohë para shqyrtimit gjyqësor, prokuroria dhe gjykata kanë qenë të informuara për sëmundjen psikike të të dënuarit H. S. i cili vuante nga sëmundja sipas shifrës F... (...), duke pasur parasysh këtë gjendje shëndetësore të të dënuarit gjykata nuk është dashur që t'ia aprovoj pranimin e fajësisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se pretendimet e mbrojtësit të dënuarit janë të pabazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as me shkelje të ligjit penal, pasi që janë dhënë arsyet dhe janë paraqitur drejtë dhe qartë arsyet për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje penalo juridike.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të dënuarit, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme fillimisht të theksoj faktin se i dënuari në shqyrtimin gjyqësor e ka bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës së shkallës së parë se janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me nenin 242 paragrafi 2 të KPP, pranimi i fajësisë ishte aprovuar.

Përkritazi me pretendimet e mbrojtësit të dënuarit për gjendjen shëndetësore të dënuarit H. S., nga shkresat e lëndës rezulton se këto pretendime për gjendjen shëndetësore në asnjë fazë të procedurës nuk janë ngritur nga vet i dënuari, apo mbrojtësi i tij, gjithashtu as nga prokuroria e

as nga gjykata nuk janë ngritur dyshimet për gjendjen e tij shëndetësore. Dhe për derisa në asnjë fazë të procedurës nuk është paraqitur ndonjë dyshim për gjendjen shëndetësore të akuzuarit, as nga palët e as nga organet por ky pretendim për shëndetin mendor të akuzuarit është paraqitur vetëm në fazën e goditjes me mjete të jashtëzakonshme, kjo gjykatë vlerëson se ky pretendim i mbrojtjes në këtë fazë mund të jetë vetëm një pretendim, më shumë për zvarritjen e procedurës se sa për sqarimin e përgjegjshmërisë.

Në të drejtën penale vlenë prezumimi i natyrshëm i rrëzueshëm se çdo kush që lind, lind mendërisht i aftë, ngase niset nga një supozim i bazuar se të gjithë personat janë të përgjegjshëm, janë psikikisht normal dhe prandaj janë edhe në gjendje që të kuptojnë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre. Prandaj, në procedurën penale administrohen provat se a ka qenë një person i përgjegjshëm apo jo vetëm në rastet konkrete, kur lind dyshimi i bazuar se kryesi i veprës penale ka qenë i papërgjegjshëm.

Kjo gjykatë vlerëson se bazuar në dispozitën e nenit 382 paragrafi 4 të KPP-së, në të cilën parashihet se kur “ankuesi pretendon në ankesë arsye të cilat nuk i ka ngritur në gjykatën themelore gjatë shqyrtimit fillestar, apo shqyrtimit gjyqësor, ankuesi nuk mund të ankohet mbi këto baza, përveç nëse vërteton se ka pasur shkaqe të jashtëzakonshme apo prova ose fakte të reja”. Andaj, referuar kësaj dispozite të lartcekur kjo gjykatë vlerëson se edhe në fazën e mjetit të jashtëzakonshëm të goditjes në këtë rast kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, pretendimet e tilla janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitës së lartcekur për veprën penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.119/2024, më datë 26.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka